



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 28/10/2021 Ref.: 3475/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 92-të, të mbajtur më 28 Tetor 2021, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Akademisë “Tempulli”, për periudhën tri (3) vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Inxhinieria e Transportit dhe Infrastruktura, BSc, 180 ECTS, me specializime në: 1. Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit, 2. Inxhinieria Infrastrukurore (rrugë, hekurudha dhe hidrologji); maksimumi 75 studentë për vit akademik
 - Inxhinieria e Trafikut dhe Siguria Rrugore, MSc, 120 ECTS, me specializime në: 1. Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit, 2. Siguria Rrugore dhe Menaxhimi i Aksidenteve, maksimumi 50 studentë për vit akademik
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Akademia “Tempulli” që deri më datë 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Ar sy e t i m i

I. "Akademia Tempulli" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Inxhinieria e Transportit dhe Infrastruktura, BSc, 180 ECTS Akreditim	Fitim Shala Ema Berisha Krasniqi Eflorim Hajra
2	Inxhinieria e Transportit dhe Infrastruktura, MSc, 120 ECTS Akreditim	Muhamed Krasniqi Mevlan Bixhaku Gëzim Hoxha

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Akademinë "Tempulli", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizita është organizuar me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Tauno Otto, Marija Vasilevska.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Inxhinieria e Transportit dhe Infrastruktura, BSc, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë në plotni një fushë (1), substancialisht pesë (5), dhe pjesërisht një (1).
2. Për programin e studimit Inxhinieria e Trafikut dhe Siguria Rrugore, MSc, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë në plotni një fushë (1), substancialisht pesë (5), dhe pjesërisht një (1).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në mbledhjen e 92 të mbajtur më 28 Tetor 2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Akademisë "Tempulli" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Akademisë "Tempulli";
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

